

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Zona
Verilindore

PROGRAMI
I KURSIT TË VEÇANTË

“QËNDISTARI”

Kodi Q-19

Miratoi:

DREJTOR

.....

Tiranë, 2019

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“QËNDISTARI”

(Q-19)

I. Profili Profesional i qëndistarit

Karakteristikat kryesore të qëndistarit

Qëndistari është i aftë të kryejë **detyrat** profesionale të qëndistarisë duke kryer vizatime të modeleve, qëndisje e mbushje të thjeshta me dorë dhe me makinë, si dhe punime përfundimtare të qëndistarisë. Ai do të angazhohet në detyra që kanë të bëjnë jo vetëm me **shprehitë** që lidhen me veprimtarinë profesionale në fushën e qëndistarisë, por edhe me **njohuritë** dhe **sjelljet** e caktuara, të cilat mundësojnë ushtrimin me sukses të këtij profesioni. Të tilla detyra janë:

- Kryerja e matjeve të ndryshme që lidhen me profesionin e qëndistarisë.
- Përzgjedhja e materialeve që përdorën në qëndistari.
- Përdorimi si duhet dhe mirëmbajtja e veglave dhe pajisjeve të punës në qëndistari.
- Vizatimi i modeleve të qëndistarisë.
- Kryerja e punimeve bazë me makinë qepëse të thjeshtë.
- Kryerja e qëndisjeve me dorë.
- Kryerja e qëndisjeve me fiston.
- Kryerja e qëndisjeve me mbushje.
- Kryerja e punimeve përfundimtare të qëndistarisë.

Për realizimin me sukses të detyrave të mesipërme Qëndistarit i duhet që të zotëroje njohuri që kanë të bëjnë me materialet që përdorën në qëndistari, matjet e ndryshme, ndërtimin dhe funksionimin e veglave dhe pajisjeve të ndryshme që përdorën në qëndistari, mënyrat e vizatimit të modeleve, llojet e tegelave të qëndisjes, rregullat e mbrojtjes në punë, të higjenës, etj.

Suksesi i Qëndistarit në këtë profesion është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** të tilla si:

korrektësia, qetësia, këmbëngulja, durueshmëria, saktësia, të qenit komunikues, të paturit fantazi, qëndrimi pozitiv ndaj profesionit etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballoje vështirësitë e punës.

a) *Mundësitë e punësimit të Qëndistarit dhe karriera profesionale e qëndistarit*

Profesioni i Qëndistarit është i lidhur ngushtë me punimet e këtij lloji të cilat kryhen në mjedise punë shtëpiake dhe punishtë e qëndistari. Me përfundimin e këtij kursi, kursanti mund të vetëpunësohet, pra të punojë individualisht për kryerjen e punimeve të qëndistarisë, sipas kërkesave të klientëve të ndryshëm. Ai mund të punësohet tek një punëdhënës tjetër, në punishte ose qëndistari. Një mundësi e tretë, por që kërkon përvoje dhe përgatitje të metëjshme, është krijimi i një biznesi të vogël të menaxhuar nga Qëndistari dhe krijimi i vendeve të punës për të tjerë.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Qëndistari,,

Në përfundim të Kursit për Qëndistar, kursanti do të jetë i aftë të:

- komunikojë me klientët dhe koleget;
- përgatisë vendin e punës;

- kryejë matje të ndryshme që lidhen me profesionin e qëndistarisë;
- përzgjedhe materialet e duhura për punë në qëndistari;
- përdorë dhe mirëmbajë veglat dhe pajisjet e punës;
- kryejë qëndisje me dorë;
- kryejë qëndisje me fiston;
- kryejë qëndisje me mbushje;
- kryejë punime përfundimtare të qëndistarisë;
- respektoje rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit në qëndistari.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për “Qëndistari,,

Pjesëmarrësit në Kursin për “Qëndistari“ duhet të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Qëndistari,,

300 orë mësimorë, ku
1 orë është = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Qëndistari”

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e qëndistarisë	Q1-001-19	10 orë mësimore Rekomandohet: 30% Teori 60% Praktikë 10% Vlerësime	1- Kursanti tregon veçoritë e profesionit të qëndistarisë. 2- Kursanti përshkruan vendin, veglat dhe pajisjet e punës së qëndistarit. 3- Kursanti përshkruan përdorimin e materialeve të punës në qëndistari. 4- Kursanti kryen punimet bazë me makinën qepëse të thjeshtë.
2	Vizatimi i modeleve dhe parapërgatitja për qëndisje	Q1-002-19	40 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	1- Kursanti parapërgatit vizatimin e modelit të qëndisjes. 2- Kursanti hedh modelin e qëndisjes në copë. 3- Kursanti përgatit copën dhe materialet ndihmëse që i nevojiten për qëndistari.

3	Qëndisjet me dorë dhe me fiston.	Q1-003-19	80 orë mësimore Rekomandohet: 15% Teori 75% Praktikë 10% Vlerësime	1- Kursanti tregon veçoritë e qëndisjeve me dorë. 2- Kursanti kryen qëndisje të thjeshta me dorë. 3- Kursanti kryen qëndisje RO-KO-KO. 4- Kursanti kryen qëndisje me “punë kryq” me dorë. 5- Kursanti kryen parapërgatitje të qëndisjes me fiston. 6- Kursanti kryen qëndisje me fiston, me dorë. 7- Kursanti kryen qëndisje me fiston, me makinë qepëse të thjeshtë.
4	Qëndisja me mbushje dhe aplikacion.	Q1-004-19	70 orë mësimore Rekomandohet: 15% Teori 75% Praktikë 10% Vlerësime	1- Kursanti tregon veçoritë e qëndisjes me mbushje. 2- Kursanti kryen qëndisje me mbushje, me dorë. 3- Kursanti kryen qëndisje me mbushje, me makinë qepëse. 4- Kursanti tregon vecoritë e qëndisjes me aplikacion. 5- Kursanti kryen qëndisjen me aplikacion me dorë. 6- Kursanti kryen qëndisje me aplikacion me makinë qepëse. 7- Kursanti kryen përfundimin dhe hekurosjen e punës me aplikacion.
5	Qëndisje me azhur.	Q1-005-19	60 orë mësimore Rekomandohet: 15% Teori 75% Praktikë 10% Vlerësime	1- Kursanti tregon vecoritë e qëndisjes me azhur. 2- Kursanti bën vizatimin e copës ku bëhet azhuri. 3- Kursanti kryen qëndisje me azhur dhe punim me dorë. 4- Kursanti kryen punime azhuri me makinë qepëse. 5- Kursanti kryen punimet përfundimtare të punimit me azhur.

6	Punime të ndryshme me aksesore.	Q1-006-19	40 orë mësimore Rekomandohet: 15% Teori 75% Praktikë 10% Vlerësime	1- Kursanti parapërgatit vizatimin e modelit të qëndisjes me aksesore. 2- Kursanti hedh modelin e qëndisjes në copë. 3- Kursanti përgatit copën dhe materialet ndihmëse që i nevojiten për qëndistari me aksesore. 4- Kursanti përgatit aksesorët dhe i hedh në copë.
7	Organizimi i ekonomisë në qëndistari dhe punimet përfundimtare.	Q1-007-19	40 orë mësimore Rekomandohet: 15% Teori 75% Praktikë 10% Vlerësime	1- Kursanti tregon veçoritë e punimeve përfundimtare të qëndistarisë. 2- Kursanti kryen punimet përfundimtare të qëndistarisë. 3- Kursanti njeh organizimin e punës në një qëndistari të vogël. 4- Kursanti kryen llogaritje ekonomike të një qëndistarie të vogël.

VI.Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko–praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko–praktik, kursantët fitojnë Certifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit të Qëndistarisë

1. Moduli “Hyrja në profesionin e qëndistarisë”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E QËNDISTARISË	Q-001-19
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko – praktik që njeh kursantët me natyrën e punës në qëndistari, me vendin, kushtet, veglat, pajisjet dhe materialet e punës, si dhe i aftëson ata të kryejnë punimet bazë me makinën qepëse të thjeshtë.	

Kohëzgjatja e modulit	1 kredit (10 orë mësimorë) Rekomandohet: 30% Teori; 60% Praktikë dhe 10% Vlerësime.
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç.
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti tregon vecoritë e profesionit të qëndistarisë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë karakteristikat dhe natyrën e punës në qëndistari; - të shpjegojë funksionet dhe detyrat kryesore në qëndistari; - të njohë prodhimet kryesore të qëndistarisë; - të shprehë kërkesat profesionale ndaj qëndistarit; - të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në qëndistari. Instrumentat e vlerësimit: - Pyetje – përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. RM 2 Kursanti përshkruan vendin, veglat dhe pajisjet e punës së qëndistarit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të shpjegojë mjedisin, vendin, kushtet dhe organizimin e punës në qëndistari; - të tregojë veglat e punës në qëndistari, ndërtimin e tyre; - të tregojë përdorimet e veglave të punës në qëndistari; - të tregojë pajisjet e punës në qëndistari, ndërtimin e tyre; - të zbatojë rregullat e mirëmbajtjes së veglave e pajisjeve të punës. Instrumentat e vlerësimit: - Pyetje – përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. RM 3 Kursanti përshkruan përdorimin e materialeve të punës në qëndistari. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë llojet e materialeve që përdoren në qëndistari dhe klasifikimi i tyre; - të tregojë pelhurat, llojet, vetitë dhe përdorimet e tyre në qëndistari; - të përshkruajë fijet, llojet, vetitë dhe përdorimet e tyre në qëndistari;

- të tregojë frazelinat, llojet, vetitë dhe përdorimet e tyre në qëndistari;
- të tregojë ngjitësat (vinovili), llojet, vetitë dhe përdorimet e tyre në qëndistari;
- të tregojë kujdes ndaj materialeve të qëndistarisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti kryen punimet bazë me makinën qepëse të thjeshtë.

Kriteret e vlerësimit.

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë ndërtimin e funksionimin e makinës qepëse të thjeshtë;
- të prezantojë llojet e punimeve që kryhen me makinën qepëse të thjeshtë;
- të tregojë pozicionin e trupit të qëndistarit për punë me makinën qepëse të thjeshtë;
- të kryejë regjistrimet në makinën qepëse të thjeshtë;
- të kryejë lëvizjet e pjesëve në makinën qepëse të thjeshtë;
- të njohë llojet e tegelave në makinën qepëse të thjeshtë;
- të zbatojë rregullat e mirëmbajtjes së makinës qepëse të thjeshtë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Pjesa më e madhe e kohës së trajtimit të këtij moduli të bëhet në repartin e qëndistarisë, si dhe të organizohen vizita njohëse në qëndistari.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të çështjeve që trajton.
- Kursantët duhet të jenë sa më tepër në kontakt me mjedisin e punës, me veglat, pajisjet dhe materialet e punës që përdorën në qëndistari.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për qepje me makinën qepëse të thjeshtë, si dhe në vëzhgime e diskutime në lidhje me mjedisin dhe natyrën e punës në qëndistari.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të synohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të njohurive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: - Repart punë për qëndistari. - Komplet i veglave të qëndistarisë (sipas Kartës DACUM) - Komplet i pajisjeve të qëndistarisë (sipas Kartës DACUM). - Makinë qepëse e thjeshtë. - Materialet e domosdoshme që përdoren në qëndistari. - Kataloge, pankarta, maketë, udhëzuesa, rregullorë, etj.
---	---

2. Moduli “Vizatimi i modeleve dhe parapërgatitja për qëndisje”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	VIZATIMI I MODELEVE DHE PARAPËRGATITJA PËR QËNDISJE.	Q-002-19
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko – praktik që njeh kursantët me kriteret dhe metodat për vizatimin në copa të modeleve të qëndisjes, si dhe i aftëson ata që të kryejnë vizatimin e modeleve në copa për qëndisje.	
Kohëzgjatja e modulit	(40 orë mësimorë) Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë dhe 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyrues, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e qëndistarit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti parapërgatit vizatimin e modelit të qëndisjes. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë metodat e vizatimit të modelit të qëndisjes; - të përcaktojë modelin e qëndisjes; - të përzgjedhë materialin e copës që do të vizatohet; - të përzgjedhë metodën për vizatim të modelit të qëndisjes; - të përzgjedhë mjetet për vizatimin e modelit të qëndisjes; - të tregojë veprimet përgatitore për vizatimin e modelit të qëndisjes (matje, prerje, hekurosje e copës). Instrumentat e vlerësimit: - Pyetje – përgjigje me gojë.	

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti hedh modelin e qëndisjes në copë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të tregojë llogaritjen, përcaktimin dhe shenimin e vendosjes së elementëve të modelit, në copë;
- të tregojë teknikën e kopjimit të modelit të qëndisjes në letër kalk;
- të përshkruajë teknikën e hedhjes së modelit të qëndisjes në copë me anë të letres kopjative;
- të përshkruajë teknikën e hedhjes së modelit të qëndisjes në copë me anë të karbonçinës;
- të tregojë teknikën e hedhjes së modelit të qëndisjes në copë me anë të shabllonit.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti përgatit copën dhe materialet ndihmese që i nevojiten për qëndistari.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të bëjë kopjimin e qëndisjes në letër kalk në copë;
- të bëjë hedhjen e qëndisjes në copë me anë të letres kopjative;
- të bëjë hedhjen e modelit të qëndisjes me anë të karbonçinës;
- të bëjë hedhjen e modelit të qëndisjes në copë me anë të shabllonit.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul mund të trajtohet në klase ose në repartin e qëndistarisë.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet dhe demonstrimet konkrete të çështjeve që trajton.
- Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në veprimtari konkrete për hedhjen e modeleve të ndryshme të qëndisjes, në copa, si dhe në vëzhgime e diskutime në lidhje me keto veprimtari Praktikë. Ata duhet të përdorin kataloge dhe materiale të tjera që ndihmojnë në vizatimin e modeleve të qëndisjes.

	- Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të synohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të njohurive të fituara.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	- Për realizimin e modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e meposhtme: - Klase mësimore ose repart punë për qëndistari. - Komploti i mjeteve për vizatimin e modeleve të qëndisjes në copa. - Copa të ndryshme në të cilat do të vizatohen modele të qëndisjes. - Modele figurash për qëndisje. - Kataloge, pankarta, udhëzues etj.

3. Moduli “Qëndisje me dorë dhe me fiston”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	QËNDISJET ME DORË DHE ME FISTON	Q-003-19
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që njeh kursantët me veçoritë dhe përdorimet e qëndisjeve me dorë, si dhe i aftëson ata të kryejnë lloje të ndryshme të qëndisjeve me dorë.	
Kohëzgjatja e modulit	(80 orë mësimorë) Rekomandohet: 15% Teori; 75% Praktikë dhe 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e qëndistarit” dhe “Vizatimi i modeleve dhe parapërgatitja për qëndisje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti tregon veçoritë e qëndisjeve me dorë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të tregojë llojet e qëndisjeve me dorë; - të përshkruajë përdorimet e llojeve të ndryshme të qëndisjeve me dorë; - të përzgjedhë veglat për qëndisjet me dorë; - të përzgjedhë materialet për qëndisjet me dorë; - të përzgjedhë vendin e punës, pozicionin e qëndistarit në qëndisje me dorë; - të zbatojë rregullat e higjenes gjatë qëndisjeve me	

dorë.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli..

RM 2 Kursanti kryen qëndisje të thjeshta me dorë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të kryejë llojet kryesorë të qëndisjeve të thjeshta me dorë;
- të kryejë analizën e modelit që do të qëndiset me dorë;
- të përzgjedhë materialet dhe veglat për qëndisjen e thjeshtë me dorë;
- të hekurosë copën;
- të kryejë hedhjen e modelit të qëndisjes në copë;
- të shpjegojë ndërtimin dhe përdorimin e gjergjefit;
- të zbatojë teknikën e qëndisjes së thjeshtë me dorë.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti kryen qëndisje RO-KO-KO.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të kryejë llojet kryesorë të qëndisjeve RO-KO-KO;
- të kryejë analizimin e modelit që do të qëndiset me RO-KO-KO;
- të përzgjedhë materialet dhe veglat për qëndisjen RO-KO-KO;
- të hekurosë copën.
- të kryejë hedhjen e modelit të qëndisjes në copë;
- të zbatojë teknikën e qëndisjes RO-KO-KO.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti kryen qëndisje me “punë kryq” me dorë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të kryejë llojet kryesorë të qëndisjeve me “punë kryq”, me dorë;
- të kryejë analizën e modelit që do të qëndiset me “punë kryq”, me dorë;
- të përzgjedhë materialet dhe veglat për qëndisje me “punë kryq”, me dorë;

- të hekurosë copën;
- të kryejë hedhjen e modelit të qëndisjes në copë;
- të zbatojë teknikën e qëndisjes me “punë kryq”, me dorë.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Kursanti kryen parapërgatitje të qëndisjes me fiston.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të tregojë veçoritë e qëndisjes me fiston;
- të dallojë llojet dhe përdorimet e qëndisjes me fiston;
- të tregojë mënyrat e punimit të fistonit (me dorë dhe me makinë);
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet për qëndisjen me fiston;
- të përzgjedhë materialet për qëndisjen me fiston;
- të kryejë procese përgatitore për qëndisjen me fiston;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të sigurimit teknik në qëndisjen me fiston.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 6 Kursanti kryen qëndisje me fiston, me dorë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të kryejë analizën e modelit që do të qëndiset me fiston, me dorë;
- të përzgjedhë materialet dhe veglat për qëndisjen me fiston, me dorë;
- të hekurosë copën;
- të hedhë modelin e qëndisjes në copë;
- të zbatojë teknika të qëndisjes me fiston, me dorë.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 7 Kursanti kryen qëndisje me fiston, me makinë qepëse të thjeshtë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të kryejë analizën e modelit që do të qëndiset me fiston, me makinë qepëse të thjeshtë;
- të përzgjedhë materialet dhe veglat për qëndisjen me fiston, me makinë qepëse të thjeshtë;
- të kryejë regjistrimin e makinës qepëse të thjeshtë për qëndisje me fiston;
- të hekurosë copën;
- të kryejë hedhjen e modelit të qëndisjes në copë;
- të zbatojë teknika të qëndisjes me fiston, me makinë qepëse të thjeshtë.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Trajtimi i këtij moduli të bëhet në repartin e qëndistarisë.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të qëndisjeve të ndryshme, me dorë.
- Kursantët duhet të jenë sa më tepër në kontakt me mjedisin e punës, me veglat, pajisjet dhe materialet e punës që përdorën gjatë qëndisjeve me dorë. Ata duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për qepje me dorë, si dhe në vëzhgime e diskutime në lidhje me qëndisjet që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të synohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të njohurive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Repart punë për qëndistari.
 - Komplet i veglave dhe pajisjeve për qëndisje me dorë.
 - Materialet e nevojshme për qëndisjen me dorë.
 - Katalogë, pankarta, udhëzuesa, materiale të shkruara etj.
-

4. Moduli “Qëndisja me mbushje dhe aplikacion.”

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	QËNDISJA ME MBUSHJE DHE APLIKACION	Q-004-19
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që njeh kursantët me veçoritë dhe përdorimet e qëndisjeve me mbushje, si dhe i aftëson ata të kryejnë lloje të ndryshme të qëndisjeve me mbushje, me dorë dhe me makinë qepëse të thjeshtë.	
Kohëzgjatja e modulit	(70 orë mësimorë) Rekomandohet: 15% Teori; 75% Praktikë dhe 10% Vlerësime.	
Kërkesat e pranimit	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e qëndistarit”, “Vizatimi i modeleve dhe parapërgatitja për qëndisje” dhe “Qëndisje me dorë dhe me fiston”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti tregon veçoritë e qëndisjes me mbushje. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të tregojë veçoritë e qëndisjes me mbushje; - të tregojë llojet dhe përdorimet e qëndisjes me mbushje; - të tregojë mënyrat e punimit të qëndisjes me mbushje (me dorë dhe me makinë); - të përzgjedhë veglat dhe pajisjet për qëndisjen me mbushje; - të përzgjedhë materialet për qëndisjen me mbushje; - të tregojë parapërgatitjen për qëndisjen me mbushje; - të zbatojë rregullat e higjienës e të sigurimit teknik në qëndisjen me mbushje. Instrumentat e vlerësimit: - Pyetje – përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. RM 2 Kursanti kryen qëndisje me mbushje, me dorë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të tregojë llojet e qëndisjeve me mbushje, me dorë; - të kryejë analizën e modelit që do të qëndiset me mbushje, me dorë; - të përzgjedhë materialet dhe veglat për qëndisjen me mbushje, me dorë; - të hekurosë copën; - të hedhë modelin e qëndisjes në copë;	

- të zbatojë teknikën e qëndisjes me mbushje “bullgare”, me dorë;
- të zbatojë teknikën e qëndisjes me mbushje “me hije”, me dorë.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti kryen qëndisje me mbushje, me makinë qepëse.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të kryejë analizën e modelit që do të qëndiset me mbushje, me makinë qepëse të thjeshtë;
- të përzgjedhë materialet dhe veglat për qëndisjen me mbushje, me makinë qepëse të thjeshtë;
- të kryejë regjistrimin e makinës qepëse të thjeshtë për qëndisje me mbushje;
- të hekurosë copën;
- të hedhë modelin e qëndisjes në copë;
- të zbatojë teknikën e qëndisjes me mbushje, me makinë qepëse të thjeshtë.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti tregon veçoritë e qëndisjes me aplikacion.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të tregojë veçoritë e qëndisjes me aplikacion;
- të tregojë llojet dhe përdorimet e qëndisjes me aplikacion;
- të përzgjedhë mënyrat e punimit në qëndisjen me aplikacion (me dorë dhe me makinë);
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet për qëndisjen me aplikacion;
- të përzgjedhë materialet për qëndisjen me aplikacion;
- të kryejë parapërgatitjen për qëndisjen me aplikacion;
- të zbatojë rregullat e higjenës e të sigurimit teknik në qëndisjen me aplikacion.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Kursanti kryen qëndisjen me aplikacion me dorë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të kryejë analizën e modelit që do të qëndiset me aplikacion, me dorë;
- të përzgjedhë materialet dhe veglat për qëndisjen me aplikacion, me dorë;
- të hekurosë copën;
- të hedhë modelin e qëndisjes në copë;
- të përgatisë copat e aplikacionit;
- të vendosë copat e aplikacionit mbi model, me dorë;
- të realizojë qëndisjen e aplikacionit me dorë;
- të kryejë zbukurimet përkatëse, me dorë;
- të kryejë pastrimin.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 6 Kursanti kryen qëndisje me aplikacion me makinë qepëse.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të analizojë modelin që do të qëndiset me aplikacion, me makinë qepëse;
- të përzgjedhë materialet dhe veglat për qëndisjen me aplikacion, me makinë qepëse;
- të kryejë regjistrimin e makinës qepëse për qëndisje me aplikacion;
- të hekurosë copën;
- të hedhë modelin e qëndisjes në copë;
- të përgatisë copat e aplikacionit;
- të vendosë aplikacionin mbi model;
- të realizojë qëndisjen e aplikacionit me makinë;
- të realizojë zbukurimet përkatëse me makinë;
- të kryejë pastrimin.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 7 Kursanti bën përfundimin dhe hekurosjen e punës që kryen me aplikacion.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të sistemojë dhe pastrojë fijen;
- të kryejë larjen përfundimtare të copës së qëndisur;
- të hekurosë copën e qëndisur;
- të kollarisë copën e qëndisur.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Trajtimi i këtij moduli të bëhet në repartin e qëndistarisë. - Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të qëndisjeve të ndryshme, me mbushje. - Kursantët duhet të jenë sa më tepër në kontakt me mjedisin e punës, me veglat, pajisjet dhe materialet e punës që përdorën gjatë qëndisjeve me mbushje. Ata duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për qëndisje me mbushje, me dorë dhe me makinë qepëse të thjeshtë, si dhe në vezhgime e diskutime në lidhje me qëndisjet që kryejnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të synohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të njohurive të fituara.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e meposhtme: - Repart punë për qëndistari. - Komplet i veglave dhe pajisjeve për qëndisje me mbushje. - Materialet e nevojshme për qëndisjen me mbushje. - Makinë qepëse e thjeshtë. - Kataloge, pankarta, udhëzues, materiale të shkruara, etj.

5. Moduli “ Qëndisje me azhur ”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	QËNDISJE ME AZHUR.	Q-005-19
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që njeh kursantët me veçoritë dhe përdorimet e punimeve përfundimtare të qëndistarisë, si dhe i aftëson ata të kryejnë lloje të ndryshme të ketyre punimeve.	
Kohëzgjatja e modulit	(60 orë mësimorë) Rekomandohet: 15% Teori; 75% Praktikë dhe 10% Vlerësime.	
Kërkesat e pranimi	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e qëndistarit”, “Vizatimi i modeleve dhe parapërgatitja për qëndisje”, “Qëndisje me dorë dhe me fiston” dhe “Qëndisje me mbushje dhe aplikacion”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM)	RM 1	Kursanti tregon veçoritë e qëndisjes me azhur. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:

**dhe procedurat e
vlerësimit**

- të tregojë llojet e punimeve përfundimtare të qëndistarisë;
- të tregojë rendesinë e punimeve përfundimtare të qëndistarisë;
- të tregojë rradhen e kryerjes së punimeve përfundimtare të qëndistarisë;
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet për punimet përfundimtare të qëndistarisë;
- të përzgjedhë materialet për punimet përfundimtare të qëndistarisë;
- të zbatojë rregullat e higjenës e të sigurimit teknik në punimet përfundimtare të qëndistarisë.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti bën vizatimin e copës ku bëhet azhuri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të prejë copën;
- të bëjë pastrimin e punës (pastrimi i penjëve);
- të bashkojë pjesët e qëndisura;
- të kryejë larjen përfundimtare të copës së qëndisur;
- të hekurosë copën e qëndisur;
- të kollarisë copën e qëndisur;
- të ambalazhojë copën e qëndisur.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti kryen qëndisje me azhur dhe punime me dorë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë modelin dhe veglat të punës për qëndisjen me azhur dhe me dorë;
- të kryejë hekurosjen e copës;
- të kryejë matjet ku do të bëhet azhuri;
- të kryejë qëndisjen e azhurit me dorë.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti kryen punime azhuri me makinë qepëse.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të kryejë analizën e modelit që do të qëndiset me azhur, me makinë qepëse të thjeshtë;

- të përzgjedhë materialet dhe veglat për qëndisjen me azhur, me makinë qepëse të thjeshtë;
- të kryejë regjistrimin e makinës qepëse të thjeshtë për qëndisje me azhur;
- të kryejë hekurosjen e copës;
- të hedhë modelin e qëndisjes në copë;
- të heqë fijet e copës në një drejtim;
- të realizojë azhurin me kollona me makinë qepëse të thjeshtë;
- të realizojë azhurin me zigzag me makinë qepëse të thjeshtë;
- të realizojë azhurin me fjongo me makinë qepëse të thjeshtë.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Kursanti kryen punimet përfundimtare të punimit me azhur.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të prejë copën;
- të kryejë pastrimin i punës (pastrimi i penjëve);
- të bashkojë pjesët e qëndisura;
- të kryejë larjen përfundimtare të copës së qëndisur;
- të hekurosë copën e qëndisur;
- të kollarisë copën e qëndisur;
- të ambalazhojë copën e qëndisur.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Udhëzime
për zbatimin e modulit**

- Trajtimi i këtij moduli të bëhet në repartin e qëndistarisë.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të punimeve përfundimtare të qëndistarisë.
- Kursantët duhet të jenë sa më tepër në kontakt me mjedisin e punës, me veglat, pajisjet dhe materialet e punës që përdorën gjatë punimeve përfundimtare të qëndistarisë. Ata duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për prerje të copës, pastrim të penjëve, bashkim të copave të qëndisura, larje, hekurosje, kollarisje dhe ambalazhim të copës së qëndisur, si dhe në vëzhgime e diskutime në lidhje me punimet që kryejnë.

	- Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të synohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të njohurive të fituara.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e meposhtme: - Repart punë për qëndistari. - Komplet i veglave dhe pajisjeve për punimet përfundimtare të qëndistarisë. - Materialet e nevojshme për punimet përfundimtare të qëndistarisë. - Kataloge, pankarta, udhëzues, materiale të shkruara, etj.

6. Moduli “Punime të ndryshme me aksesore”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	PUNIME TË NDRYSHME ME AKSESORË.	Q-006-19
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko – praktik që njeh kursantët me kriteret dhe metodat për vizatimin në copa të modeleve të qëndisjes, si dhe i aftëson atë që të kryejnë punimet e qëndisjes me aksesore.	
Kohëzgjatja e modulit	(40 orë mësimorë) Rekomandohet: 15% Teori; 75% Praktikë dhe 10% Vlerësime	
Kërkesat e pranimi	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e qëndistarit”, “Vizatimi i modeleve dhe parapërgatitja për qëndisje”, “Qëndisje me dorë dhe me fiston”, “Qëndisje me mbushje dhe aplikacion” dhe “Qëndisje me azhur,,.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Kursanti parapërgatit vizatimin e modelit të qëndisjes me aksesore. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të tregojë metodat e vizatimit të modelit të qëndisjes me aksesore; - të përcaktojë modelin e qëndisjes me aksesore; - të përzgjedhë materialin e copës që do të vizatohet modeli;

-
- të përzgjedhë llojin e aksesorëve për qëndisje;
 - të parapërgatisë veprimet përgatitorë për qëndisjen e modelit. (matje, prerje, hekurosje e copës).

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti hedh modelin e qëndisjes në copë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të llogarisë, përcaktojë dhe shenojë vendosjen e elementëve të modelit, në copë;
- të bëjë modelin e qëndisjes në letër kalk;
- të bëjë hedhjen e modelit të qëndisjes në letër kopjative;
- të bëjë hedhjen e modelit të qëndisjes në copë me anë të karbonçinës;
- të bëjë hedhjen e modelit të qëndisjes në copë me anë të shabllonit.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti përgatit copën dhe materialet ndihmese që i nevojiten për qëndistari me aksesorë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të bëjë kopjimin e qëndisjes në letër kalk në copë;
- të bëjë hedhjen e qëndisjes në copë me anë të letres kopjative;
- të bëjë hedhjen e modelit të qëndisjes me anë të karboncinës;
- të bëjë hedhjen e modelit të qëndisjes në copë me anë të shabllonit.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti përgatit aksesorët dhe i hedh në copë.

Kriteret e vlerësimit :

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të bëjë punimin e aksesorëve në copë;
- të ndjekë modelin e vizatuar;
- të kombinojë ngjyrat e madhesinë e aksesorëve;
- të kryejë prerjen e penjëve dhe sistëmimin e punimit;
- të paraqesë punën e bërë.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul mund të trajtohet në klase ose në repartin e qëndistarisë. - Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet dhe demonstrimet konkrete të çështjeve që trajton. - Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në veprimtari konkrete për hedhjen e modeleve të ndryshme të qëndisjes, në copa, si dhe në vëzhgime e diskutime në lidhje me keto veprimtari praktike. Ata duhet të përdorin kataloge dhe materiale të tjera që ndihmojnë në punimin me aksesorë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të synohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të njohurive të fituara.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e meposhtme: - Klase mesimorë ose repart punë për qëndistari. - Komplet i mjetëve për punimin e modeleve të qëndisjes me aksesorë. - Aksesorë të ndryshëm me të cilat do të qëndisen modelet. - Modele figurash për qëndisje. - Kataloge, aksesorë, pankarta, udhëzues etj.

7. Moduli “Organizimi i ekonomisë në qëndistari dhe punimet përfundimtare.”

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	ORGANIZIMI I EKONOMISË NË QËNDISTARI DHE PUNIMET PËRFUNDIMTARE.	Q1-007-19
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që njeh kursantët me veçoritë dhe përdorimet e qëndisjeve me fiston, si dhe i aftëson ata të kryejnë lloje të ndryshme të qëndisjeve me fiston, me dorë dhe me makinë qepëse të thjeshtë.	
Kohëzgjatja e modulit	(40 orë mësimorë) Rekomandohet: 15% Teori; 75% Praktikë dhe 10% Vlerësime.	
Kërkesat e pranimit	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e qëndistarit”,	

“Vizatimi i modeleve dhe parapërgatitja për qëndisje”, “Qëndisje me dorë dhe me fiston”, “Qëndisje me mbushje dhe aplikacion”, “Qëndisje me azhur,, dhe “Punime të ndryshme me aksesorë”.

**Rezultatet e të
mësuarit (RM)
dhe procedurat e
vlerësimit**

RM 1 Kursanti tregon veçoritë e punimeve përfundimtare të qëndistarisë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të tregojë llojet e punimeve përfundimtare të qëndistarisë;
- të tregojë rendësinë e punimeve përfundimtare të qëndistarisë;
- të tregojë rradhën e kryerjes se punimeve përfundimtare të qëndistarisë;
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet për punimet përfundimtare të qëndistarisë;
- të përzgjedhë materialet për punimet përfundimtare të qëndistarisë;
- të zbatojë rregullat e higjenës e të sigurimit teknik në punimet përfundimtare të qëndistarisë.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti kryen punimet përfundimtare të qëndistarisë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të prejë copën;
- të bëjë pastrimin e punës (pastrimi i penjëve);
- të kryejë bashkimin e pjeseve të qëndisura;
- të kryejë larjen përfundimtare e copës se qëndisur;
- të hekurosë e copën e qëndisur;
- të kollarisë copën e qëndisur;
- të ambalazhojë copën e qëndisur.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti njeh organizimin e punës dhe në një qëndistari të vogël.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të njohë format ligjorë të organizimit të një biznesi të vogël në fushën e qëndistarisë;
- të kryejë organizimin dhe ndarjen e punës në një qëndistari të vogël;

- të njohë legjislacionin e punës dhe veçoritë ligjorë në fushën e qëndëtarisë;
- të njohë legjislacionin fiskal në fushën e qëndëtarisë;
- të njohë kontratat me klientët.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti kryen llogaritje ekonomike të një qëndëtarie të vogël.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të kryejë kapitalin fillestar për një qëndëtarie të vogël;
- të dijë kostot në qëndëtarie, tipet dhe përberesit e kostove;
- të bëjë llogaritjen e kostove të produktëve të qëndëtarisë;
- të dijë të ardhurat në qëndëtarie, llogaritjen e të ardhurave.
- të llogarisë fitimin në qëndëtarie;
- të bëjë bilancin financiar të një qëndëtarie.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Trajtimi i këtij moduli të bëhet në repartin e qëndëtarisë.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të qëndësive të ndryshme, me fiston.
- Kursantët duhet të jenë sa më tepër në kontakt me mjedisin e punës, me veglat, pajisjet dhe materialet e punës që përdorën gjatë qëndësive me fiston. Ata duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për qëndësi me fiston, si dhe në vëzhgime e diskutime n lidhje me qëndësjet që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të synohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të njohurive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
 - Repart punë për qëndëtarie.
 - Komplet i veglave dhe pajisjeve për qëndësi me fiston.
 - Materialet e nevojshme për qëndësjen me fiston.
 - Makinë qepëse e thjeshtë.
 - Kataloge, pankarta, udhëzues, materiale të shkruara, etj.
-